



**KOMUNA E PRISHTINËS**  
**RAPORT MUJOR**

Drejtoria	<b>Drejtoria e Arsimit</b>
Periudha Raportuese	<b>Gusht, 2020</b>
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fatos Osmani

**1. PËRMBLEDHJE**

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes /ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Pavarësisht vështirësive dhe sfidave të mëdha që ka paraqitur përhapje e pandemisë COVID-19, Drejtoria e Arsimit me përkushtim dhe profesionalizëm të lartë, ka arritur që gjatë muajit gusht t'i realizojë punë dhe detyra të shumta të parapara sipas Planit të veprimit dhe punë dhe detyra të tjera të paraqitura.

**AKTIVITETET E PLANIFIKUARA**

Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj:

- Mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit edukativo-arsimor;
- Vizita të përgjithshme-këshilluese në institucionet arsimore;
- Vlerësimi i nevojave dhe sigurimi i personelit të kualifikuar për DKA dhe IEAA. Rishikimi dhe hartimi i kriterëve për punësim;
- Krijimi i ekipeve në nivel të institucioneve edukative e arsimore për përgatitjen dhe koordinimin e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të performancës së shkollës;

- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Mbikëqyrja/mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve për punë praktike;
- Sigurimi i buxhetit adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA – shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performances;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Organizimi i punëtorive të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatimi i planit për tejkalimin e masave/ sfidave/ vështirësive/ pengesave;
- Monitorimi i zbatimit të kurrikulës;
- Organizimi i takimeve dhe punëtorive për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave, me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht, sigurohet pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Funkcionalizimi i pajisjeve të TIK-ut;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Krijimi i mekanizmave brenda shkollave, të cilat do të jenë në komunikim të vazhdueshëm me këta donatorë;
- Rritja e llojeve të shërbimeve (dhe gjenerimi i të hyrave për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në IP) të edukimit parashkollor;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor;
- Aftësimi i personelit për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK dhe KB në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);

- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatri, nutricionisti, e të tjerë në IP, me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Shërbimet shëndetësore-pedagogjike dhe psikologjike hartojnë plane pune të integruara sipas nevojave dhe kërkesave të IP-ve;
- Ekipi komunal harton planin e përmirësimit për tejkalimin e problemeve dhe avancimin e standardeve të IP-ve në komunë;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Trajnimi i mësimitdhënësve për shmangie të ndëshkimit fizik ndaj nxënësve;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimitdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Në nivel komunal dhe institucional, organizohen takime informative dhe konsultative me prindër dhe me komunitetin me orar dhe agjendë të caktuara saktë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Takime të rregullta me komunitetin;
- Angazhimi aktiv i prindërve në realizimin e kurrikulave;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Angazhimi i prindërve për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA përkrahë NNV dhe nxënësit me talente;
- Përkrahja e punës së Ekipit Komunal për Vlerësim;
- Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektiv;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- DKA harton rregulloren për mjedis miqësor për të nxënë efektiv;
- Organizimi i ngjarjeve për vetëdijësimin e punëtorëve arsimorë, për nevojën e krijimit të kushteve optimale të punës e mësimit nëpër shkolla;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Furnizimit me material higjienik i institucioneve arsimore;
- Furnizimi me libra, për nxënësit e klasave (I-IX);
- Furnizimi me material pedagogjik;
- Furnizimi me material didaktik;
- Furnizimi me mjete pune për shkolla;
- DDD i shkollave etj.
- Përcjella dhe realizimi projekteve nga donatorët;

- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve;
- Barazimi i pagesave me freebalance.

## 2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtorja juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e Drejtorisë.

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit, të cilët sipas planit dinamik, janë duke operuar në terren dhe duke e përcjellë nga afër ecurinë e zhvillimeve në arsim dhe, njëkohësisht duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale;

Sipas dinamikës së planifikuar, përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit, kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, kontrolluese, speciale dhe të përgjithshme në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar. Pra, në kuadër të mbikëqyrjes dhe mbështetjes profesionale në të gjitha dimensionet që janë paraqitur nevojat. Kështu që, sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë, gjatë muajit gusht të vitit 2020 është realizuar planin e punës. Pra, në këtë periudhë raportuese janë realizuar **10 vizita informuese, në:**

- SHML “Sami Frashëri”;
- SHFMU “Ismail Qemali”;
- SHFMU “Gjergj Fishta”;
- SHFMU “Asim Vokshi”;
- SHFMU “Elena Gjika”;
- SHFMU “Naim Frashëri”;
- SHFMU “Isa Boletini”;
- SHFMU “Filip Shiroka”;
- SHFMU “Faik Konica”;
- SHFMU “Nexhmi Mustafa”.

**Vizitë kontrolluese lidhur me regjistrimin në klasë X, në:**

- SHML “Xhevdet Doda”;
- SHML “Sami Frashëri”;
- SHML “Ahmet Gashi”;
- SHML “Eqrem Çabej”;
- SHML “Dr.Ali Sokoli”;

- SHML “28 Nëntori” dhe institucionet parashkollore.

**2 vizitë speciale**, njëra në institucionin parashkollor “Yllkat” dhe njëra në shkollën fillore dhe të mesme të ulët “Mehmet Gjevori”.

- **Zhvillimi dhe ngritja profesionale e mësimeve për zbatimin në praktikë të KK-së dhe KB-së.**

Drejtorja e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në koordinim dhe bashkëveprim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në vazhden e përmirësimit dhe ngritjes së kapaciteteve

profesionale të mësimeve, dhe në veçanti në funksion të implementimit dhe zbatimit me sukses të kurrikulës së re në institucionet edukativo-arsimore, nga sot, më 26



gusht 2020, organizojnë trajnime për zhvillimin profesional të 132 mësimeve të

komunës së Prishtinës dhe të komunave tjera të Republikës së Kosovës.

Andaj, ngritja dhe zhvillimi profesional i mësimeve do të realizohet në fushat e kurrikulës, gjuhët dhe komunikimi, matematikë, shkencat shoqërore-natyrore,



klasat përgatitore dhe fillor, për të gjithë ata të cilët nga vitit i ri shkollor 2020-2021, që do të fillojnë zbatimin në praktikë të këtij dokumentit zyrtar.

-

- Drejtoria e Arsimit, në funksion të fillimit të vitit të ri shkollor 2020-2021, në koordinim me drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore dhe duke u mbështetur në rekomandimet IKPSH dhe MASH, kanë hartuar rregullat protokollare për hapjen e shkollave nga shtatori i vitit 2020, duke përcaktuar masat të cilat duhet të respektohen, në mënyrë që të mbrohem nga përhapja e pandemisë COVID-19.



Drejtoria e Arsimit, komfor kompetencave dhe përgjegjësive që ka, do t'i përgjigjet situatë në mënyrë profesionale, në mënyrë që organizimi i mësimit në këtë gjendje pandemie, të zhvillohet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara;

- Drejtoria e Arsimit, në funksion të zhvillimeve dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, ka zgjedhur koordinatoren e cilësisë në nivel komune dhe njëkohësisht në vijimësi është duke bërë përpjekje që në secilën shkollë të emërohet koordinatori i cilësisë;

- Më 14 gusht, drejtoresha e Arsimit, znj. Shpresa Shala, bashkë me nënkryetarin e Komunës, z. Muhedin Nushi, priten në takim Ministrin e Arsimit, z. Ramë Likaj, ku temë diskutimi ishte përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021.



Po ashtu, në këtë takim u diskutuan skenarët e përgatitur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,

dhe ndihmën e cila do të iu ofrohet komunave përmes donatorëve, si dhe përgatitjet që po i bën Komuna e Prishtinës dhe mundësinë e hapjes së shkollave sipas skenarëve, duke u bazuar në specifikat e shkollave të kryeqytetit. Temë tjetër ishte rëndësia e fuqizimit të shkollave profesionale për të iu

përshtatur tregut të punës. Ministri u zotua se do të përkrahë çdo projekt në funksion të ngritjes së cilësisë së arsimit;

- Në funksion të krijimit të kushteve për edukim cilësor dhe sipas standardeve të kërkuara, Drejtoria e Arsimit gjatë muajit gusht, ka intervenuar në përmirësimin e infrastrukturës së brendshme në disa institucione arsimore.

- **Marrëveshje bashkëpunimi**

Më 20 gusht, Drejtoria e Arsimit ka nënshkrua memorandum bashkëpunimi me

joqeveritare PEN - Peer Educators Network, për realizimin e projektit "Youth Care For Kosovo."

Me këtë projekt synohet të rrisin aftësitë e aktivistëve për çështje mjedisore, avokim dhe lobim gjatë gjithë projektit.

Projekti synon të rrisë vetëdijësimin për

çështjet e mjedisit dhe u mundëson qytetarëve të ndërmarrin veprime të drejtpërdrejta në drejtim të përmirësimit të mjedisit brenda komuniteteve të tyre, pra duke promovuar në shkallë vendi të drejtat shëndetësore si të drejta themelore të njeriut.

Projekti synon të angazhojë aktivistë nga komuna e Prishtinës, për të avokuar politika më të mira brenda komuniteteve të tyre për çështje mjedisore, siç janë cilësia e ajrit dhe ujit, ruajtja e mjedisit, menaxhimi i mbeturinave dhe ndër të tjera burimet alternative të energjisë.



- **Regjistrimi i nxënësve në klasë të parë (I) dhe në klasë të dhjetë (X), për vitin shkollor 2020-2021:**

Drejtoria e Arsimit, për regjistrimin e nxënësve në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të lartë, konkretisht klasën e parë (I) dhe të dhjetë (X), ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që ky proces të rrjedhë sipas standardeve dhe kushteve të përcaktuara, dhe në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, UA dhe kriteret e regjistrimit të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Arsimit.

Andaj, për vitin shkollor 2020-2021, në Komunën e Prishtinës janë planifikuar të regjistrohen në klasën e **parë (I) gjithsej 3445** nxënës të shpërndarë në **140 paralele**, ndërsa në klasën e **dhjetë (X)**, në gjimnaze dhe shkolla profesionale janë planifikuar **3328 nxënës** të shpërndarë në **114 paralele**.

### **Gjimnazet:**

Në Komunën e Prishtinës, veprimtaria edukativo-arsimore zhvillohet në gjashtë gjimnaze, të cilët për vitin shkollor 2020-2021, kanë planifikuar dhe regjistruar **1618 nxënës** në klasë të dhjetë (X).

Por, nga analiza dhe vlerësimi i përgjithshëm mbi trendët dhe ecurinë e procesit të regjistrimit të nxënësve në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, konkretisht në gjimnaze, konstatohet se tendenca për regjistrim në këto institucione ka qenë e madhe në raport me shkollat profesionale.

### **Shkollat profesionale:**

Në komunën e Prishtinës, veprimtaria edukativo-arsimore zhvillohet edhe në shtatë shkolla profesionale, ku dy nga to janë të tipit të shkollave profesionale të veprimtarisë shoqërore dhe pesë në tipin e shkollave profesionale të veprimtarisë prodhuese. Andaj, për vitin shkollor 2020-2021, është planifikuar regjistrimi i **1710 nxënësve** në këto institucione arsimore.

Por, nga analiza dhe vlerësimi i përgjithshëm mbi trendët dhe ecurinë e procesit të regjistrimit të nxënësve në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, konkretisht në shkollat profesionale, konstatohet se ka pasur trend pozitiv për t'u regjistruar në këto institucione, por jo në nivelin e kënaqshëm aty ky synohet.

Pra, në tipin e shkollave profesionale të veprimtarisë shoqërore, kërkesat për regjistrim në vitin shkollor 2020-2021 janë të mëdha, ku janë plotësuar të gjitha vendet, përveç të paralelja e komunitetit boshnjak, ndërsa të tipi i shkollave profesionale të veprimtarisë prodhuese, ka pasur progres për të vijuar mësimet në këto shkolla, por jo në nivelin e dëshiruar;

- Drejtoria e Arsimit në koordinim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, më 29 gusht 2019, organizuan Testin shtetëror të Maturës. Në Komunën e Prishtinës Testi shtetëror i Maturës është organizuar në njëmbëdhjetë (27) qendra testuese, ku këtë afat testit iu nënshtruan 4121 nxënës;
- Për vlerësimin e nxënësve-fëmijëve me nevoja të veçanta, ekipi në nivel komune ka operuar sipas planifikimeve të parapara për vlerësimin dhe adresimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet përkatëse. Por, gjatë kësaj periudhe raportues nuk ka pasur kërkesë për vlerësim të fëmijëve-nxënësve;
- Drejtoria e Arsimit, në kohën e duhur ka përcjellë Udhëzimin administrativ 08/2016, për vlerësimin e nxënësve sipas Kornizës së kurrikulës së arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht modelin sipas standardeve të kërkuara për vlerësim. Po ashtu, janë përcjellë edhe informata të tjera të domosdoshme në të gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar, janë dhënë këshilla të nevojshme për këtë proces, por duhet theksuar se vlerësimi akoma mbetet sfidë dhe ka nevojë për mbështetje permanente;
- Takime të rregullta me zyrtarë për arsim në DKA, për të trajtuar çështje me interes e që ndërlidhen me ato të sigurisë në shkolla;



- Takime me prindër të shkollave të ndryshme;
- Vizita në shkolla, sipas kërkesave të shkollave, prindërve apo nxënësve;
- Takim me palët e interesit dhe zyrtarë komunalë nga drejtoritë tjera përkatëse;
- Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve të të gjitha shkresave zyrtare të paraqitura gjatë muajit gusht;
- Pjesëmarrja në procedurat e hapjes dhe vlerësimeve të tenderëve për nevojat e institucioneve arsimore. Në procesin e hapjes dhe vlerësim të tenderëve marrin pjesë gjithnjë nga tre përfaqësues të Drejtorisë së Arsimit;
- Janë furnizuar në vazhdimësi të gjitha institucionet me materiale didaktike, higjienike dhe mallra dhe shërbime tjera;
- Janë furnizuar me libra nxënësit e klasave 1-9;
- Janë furnizuar shkollat me material pedagogjik;
- Është bërë DDD- e shkollave;
- Janë furnizuar shkollat me mjete pune etj.
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve.

### 3. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- Vizita të vazhdueshme, të përgjithshme, kontrolluese dhe speciale në institucionet edukativo-arsimore;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA – shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Furnizimi i shkollave me inventar;
- Furnizimi me material higjienik;
- Furnizimi me material didaktik.

#### 3.1.1. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika të tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

#### 3.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, gusht 2020;

<b>Buxheti i shpenzuar dhe alokuar gusht-2020</b>				
<b>Kategoria eko.</b>	<b>Alokim</b>	<b>Shpenzim</b>	<b>Zotim -Oblig</b>	<b>Mbetje -S=</b>
Paga	1,493,569.13	1,493,569.13	-	-
Komunali	205,358.79	6,882.79	4,842.32	193,633.68
10-MSH	888,520.49	82,189.76	269,318.57	537,012.16
21-MSH	275,736.2	-	-	275,736.16
Subvencione	111,830.00	2,100.00	2,000.00	107,730.00
Donacione	28,056.48	-	-	28,056.48
Huaja-Grant i BB	148,321.80	10,045.30	595.00	137,681.50
FB-21-Kapitale	1,107,030.12	59,979.75	119,332.50	927,717.87
FB-22-Kapitale	2,517,453.37	105,712.78	115,900.00	2,295,840.59
<b>Totali:</b>	<b>6,775,876.34</b>	<b>1,760,479.51</b>	<b>511,988.39</b>	<b>4,503,408.44</b>

### 3.1.3. Takimet me palë:

- Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit gusht ka realizuar mbi 67 takime me palë;
- Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit janë të planifikuara katër ditë në javë.

### 4. Takimet me institucione të tjera

Për periudhën e muajit gusht të vitit 2020, janë realizuar takime me:

- ministrin e Arsimit dhe Shkencës;
- përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit;
- Inspektorët e arsimit;
- përfaqësuesit e GIZ-it;
- përfaqësuesit e KEC-it;
- inspektorët e Ministrisë së Mirëqenies Sociale;
- Policinë e Kosovës;
- Kolegjiumin e arsimit-Asociacionin e komunave të Kosovës;
- përfaqësuesit e KRU "Prishtina";

- përfaqësuesit e KEDS;
- përfaqësuesit e PTT-së.

#### 4.1.1. Diskutime publike/takimet me qytetarë

### 5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

- Gjatë muajit gusht, në Drejtorinë e Arsimit nuk është adresuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

#### 5.1.1. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

- Gjatë muajit gusht janë pranuar gjithsej 78 lëndë, prej tyre të pezulluara 07 lëndë dhe në proces janë edhe 71 lëndë.

### 6. Takime të tjera

- Takime me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takim me këshilla drejtues të shkollave;
- Takime me mësimdhënës.

### 7. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë.

- Riorganizimi dhe përcaktimi i përgjegjësive, punëve dhe detyrave në Drejtorinë e Arsimit;
- Mungesa e një stafit profesional e mbikëqyrës të veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Mungesa e një mekanizmi për vlerësimin e performancës së stafit edukativo-arsimor;
- Mungesa e zyrtarëve ligjorë në Drejtorinë e Arsimit;
- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale;
- Kompetenca të përziera dhe jo të qarta;
- Implementimi i kurrikulës së re,
- Përhapja e pandemisë COVID-19;
- Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021.

## 8. REKOMANDIME

Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë etj.

- Riorganizimi i menjëhershëm i Drejtorisë së Arsimit, në bazë të përgjegjësi, punëve dhe detyrave që ka kjo drejtori;
- Plotësimi i stafit profesional sipas kërkesave dhe nevojave të Drejtorisë së Arsimit;
- Formimi i një organi mbikëqyrës të performancës së veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Riorganizimi i rrjetit shkollor të viseve rurale të komunës së Prishtinës.

## 9. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita sistematike në institucionet edukativo-arsimore;
- Vizita speciale IEAA;
- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Sigurimi i buxhetit adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA – shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Organizimi i punëtorive të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatimi i planit për tejkalimin e masave/ sfidave/ vështirësive/ pengesave;
- Monitorimi i zbatimit të kurrikulës;
- Organizimi i takimeve dhe punëtorive për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave, me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;

- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Klubet për përkrahje teknike;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi, që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Rritja e llojeve të shërbimeve (dhe gjenerimi i të hyrave për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në IP) të edukimit parashkollor;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor;
- Aftësimi i personelit për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK dhe KB në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti etj. në IP, me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësimi Profesional);
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Në nivel komunal dhe institucional, organizohen takime informative dhe konsultative me prindër dhe me komunitetin, me orar dhe agjendë të caktuara saktë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Takime të rregullta me komunitetin;
- Angazhimi aktiv i prindërve në realizimin e kurrikulave;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- DKA përkrahë NNV dhe nxënësit me talente;
- Përkrahja e punës së Ekipit Komunal për Vlerësim;
- Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektiv;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;

- DKA harton rregulloren për mjedis miqësor për të nxënë efektiv;
- Organizohen ngjarje për vetëdijesimin e punëtorëve arsimorë për nevojën e krijimit të kushteve optimale të punës e mësimit nëpër shkolla;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Furnizimi i shkollave me pajisje teknologjike;
- Furnizimi me inventar i shkollave;
- Furnizimi me makina pastrimi;
- Furnizimi me rekuizita sportive;
- Furnizimi i shkollave me naftë;
- Furnizimi me libra i bibliotekave shkollore;
- Hapja e bunarëve;
- Furnizimi me material didaktik;
- Përcjellja dhe realizimi projekteve nga donatorët;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve.

## 10. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.